



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2188 Regj  
Nr.451 Prot

Tiranë, më 19.02.2024

URDHËR  
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit  
Adresa: Tirane  
Drejtuar: “AL-POINT” sh.p.k me nipt L02010022D  
Adresa: Rruga Myslym Keta, Shish Tufine, prane Poliklinikes Shtetore, Dajt, Tirane  
Per djeni: “PEPA GROUP” Sh.p.k. Nipt L42215009L  
Adresa: Autostrada Tirane Durres, Km. 6, Kashar, Tirane.

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.13867Akti, date 28.12.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2188, Datë 15.01.2024 kërkesën e kreditorit “PEPA GROUP” Sh.p.k. Nipt L42215009L ndaj debitorit “AL-POINT” sh.p.k me nipt L02010022D, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature tatimore e shitjes me Nr.serial 96868160 date 02.03.2021 – e vijuese deri ne fatura tatimore e shitjes me Nr.serial 8205cd01-899c-40ec-btbb-59a10b6b2blc date 05.09.2021, total 37 (cope) fatura”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.97 Prot, Datë 15.01.2024, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit “Vendimi Nr.13867Akti, date 28.12.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane” në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile Me Shkresën Nr.416 Prot, datë 15.02.2024, dhe shkresen Nr.385 Prot date 13.02.2024 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi aktivet e pales debitore AL-POINT” sh.p.k me nipt L02010022D, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimit të llogarive bankare rezulton qe detyrimi, eshte ekzekutuar teresisht.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.416 Prot, datë 15.02.2024, dhe shkresen Nr.385 Prot date 13.02.2024, mbi aktivet e pales debitore “AL-POINT” sh.p.k me nipt L02010022D, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.

2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.

3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdheri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

“ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE”

PËRMBARUESI GJYQËSOR  
ERIS SOTIRI